



Mësimi në distancë i kushtoi MASHTI-t mbi 120 mijë euro



Asnjë rast me COVID-19, shërohen 5 persona



Kosova duhet të shkojë në zgjedhje, edhe pse nuk i konvenojnë askujt

Shkruan:
Augustin Palokaj



"New York Times" ua kushton ballinën viktimave të virusit



Faqe 2

Faqe 4

Faqe 11

Faqe 7

KOHA DITORE

e hënë • 25 maj 2020

Numri 8206 • Çmimi 0,50 €

www.koha.net



BASHKIMI EVROPIAN DEKLAROHET UNIK SA U PËRKET KORNIZAVE DHE PARIMEVE NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Brukseli kërkon marrëveshje për të gjitha çështjet e pazgjidhura

Me gjithë deklaratat kontradiktore sa u përket opsioneve dhe kompromiseve që mund të shkojnë deri në shkëmbim terriore, zyrtarë të Bashkimit Evropian kanë folur për veprime intensive në rinisjen e dialogut Kosovë-Serbi. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Peter Stano, ka thënë për "Kohën Ditore" se prioritetet e tyre është lehtësimi i palëve drejt një marrëveshjeje finale që trajton të gjitha problemet e pazgjidhura mes dy vendeve, por të njëjtën kohë respekton vlerat evropiane dhe të drejtën ndërkombëtare

Fitim Gashi

Prishtinë, 24 maj - Bashkimi Evropian vazhdon të proklamojë unitet karshi çasjes që synon të aplikojë në lehtësimin e dialogut Kosovë-Serbi, me gjithë deklaratat kontradiktore sa u përket opsioneve dhe kompromiseve që mund t'i bëjnë palet. Një përfshirje më të madhe në këtë proces e kanë paralajmëruar Gjermania dhe Franca, nëpërmjet ministrave të Jashtëm. Në një opinion publikuar në "Kohën Ditore", ministrit kanë folur për urgjencën e rinisjes së dialogut, duke përmendur edhe mundësinë e organizimit të një samiti tjetër në Paris.

Derisa shefi i diplomacisë evropiane, Joseph Borrell, para disa ditësh ka thënë se, mundësia e shkëmbimeve territoriale mes Kosovës dhe Serbisë është çështje që duhet t'u libet palëve të vendosin, vartësi i tij Miroslav Lajčak, i cili është caktuar emisar special për dialogun Kosovë-Serbi dhe Ballkanin Perëndimor, e ka përjashtuar mundësinë që shkëmbimi i terrioreve të jetë në agjendën e tij.

Në zyrën e Komisionit Evropian kanë thënë se BE-ja është unike sa u përket kornizave dhe parimeve që duhet ndjekur në dialogun mes

dy vendeve, dhe se nuk ka dallime në qëndrime.

"Deklaratat e përfaqësuesit të lartë/zëvendësprezidentit (HRVP), Josep Borrell, dhe përfaqësuesit special të BE-së (EUSR), Miroslav Lajčak, janë konsistente dhe në përputhje me qëndrimet tona të kahershme. Te pretendosh ndryshe është keqinterpretim dhe në fakt është jo i saktë. J. Borrell vazhdimisht ka mbrojtur qëndrimin që Serbia dhe Kosova pa vonesa duhet t'i zgjidhin të gjitha çështjet e pazgjidhura - ky është prioritet për Bashkimin Evropian dhe gjithashtu duhet të jetë edhe për ta", ka thënë për "Kohën Ditore" zëdhënësi i Komisionit Evropian, Peter Stano.

Sa i përket përmbajtjes së marrëveshjes finale, sipas Stano, ajo duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe vlerat e Bashkimit Evropian, në respektim edhe të së drejtës ndërkombëtare.

"Serbia dhe Kosova duhet të nënshkruajnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin - ky do të ishte sinjal që ato përfundimisht merrren me të kaluarën dhe janë të gatshme të ecin përpara në rrugën përkatëse evropiane.

vijon në faqen e tretë



Oborri i Xhamisë së Madhe në Prishtinë, në ditën e faljes së namazit të Fitër Bajramit, ka qenë i zbrazët. Shkaku i rrezikut nga përhapja e koronavirusit dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, kjo xhami, si dhe të tjerat në Kosovë të dielën ishin të ndaluara për besimtarët myslimanë. Ceremonia kryesore e faljes së Fitër Bajramit u mbajt nga një grup i vogël i hoxhallarëve të udhëhequr nga myftiu Naim Tërnavë. Nga aty, Tërnavë u ka bërë thirrje qytetarëve për durim dhe shmangie nga vizitat familjare. Festën e Fitër Bajramit besimtarëve myslimanë ua kanë uruar edhe drejtuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërsa kanë përcjellë mesazhe urimi e paqeje, ata kanë përgëzuar qytetarët për solidaritetin dhe mirëkuptimin e treguar

BLLOKIMI I AKTIVITETEVE EKONOMIKE DHE RËNIA E KONSUMIT ULIN IMPORTET DHE EKSPORTET

Pandemia ul deficitin tregtar për 37 për qind

Sanie Jusufi

PRISHTINË, 24 MAJ - Tregtia e jashtme ka pësuar goditje të ndjeshme si pasojë e bllokimit të shumë aktiviteteve ekonomike gjatë pandemisë COVID-19. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, importi për muajin prill ka pësuar rënie prej 34.4 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Edhe eksporti kanë pësuar rënie prej 11.5 për qind. Gjatë prillit u importuan mallra në vlerë 193.9 milionë euro, ndërsa vlera e eksporteve ishte 32.6 milionë euro.

Kjo ka ndikuar në uljen e deficitit tregtar prej 161.2 milionë eurosh apo 37.6 për qind, ku eksporti ka mbuluar importin me 16.9 për qind. Vitin e kaluar deficitit tregtar

ishte 258.5 milionë euro.

Heqja e tarifës prej 100 për qind për mallrat serbe dhe vendosja e reciprocitetit më 1 prill, kanë ndikuar që Serbia të jetë në mesin e importuesve më të mëdhenj në Kosovë. Ajo prin në tregline me vendet e CEFTA-s. Vetëm gjatë muajit prill ka importuar mallra në vlerë mbi 15 milionë euro. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin importuar mallra në vlerë vetëm 673 euro.

Partnere e Kosovës në import nga vendet e Bashkimit Evropian ka vazhduar të jetë Gjermania me afro 20 milionë euro mallra. Në mesin e importuesve më të mëdhenj në Kosovë janë edhe Turqia me mbi 21 milionë euro dhe Kina me afro 17 milionë euro.

Ndërsa produktet nga Kosova

gjatë muajit, ndonëse të pakta, kanë qenë të pranishme kryesisht në tregun e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi, Gjermanisë e Zvicrës.

Sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukliqi, bllokimi i aktiviteteve ekonomike dhe rënia e konsumit kanë ndikuar në uljen e deficitit tregtar.

"Arsyeja për këtë është pandemia, pasi nëse e krahasojmë me vitin e kaluar e shohim se të shumë artikuj të lëndës së parë dhe atyre joesenciale kemi rënie të importit, gjë që tregon edhe uljen e fuqisë blerëse, dobësimin e potencialëve të konsumatorëve për të blerë produkte, por në të njëjtën kohë edhe rënia e aktiviteteve prodhuese në vend", ka thënë Rukliqi.

Zëvendësministri në detyrë i Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Edison Jakurti, ka thënë se zvogëlimi i deficitit është lajm i mirë nga tregtia e jashtme.

"Në muajin prill 2020 krahasuar me muajin prill 2019 Kosova ka eksportuar rreth 4.3 milionë euro më pak dhe ka importuar rreth 101.5 milionë euro më pak. Kjo do të thotë rënie e eksportit për 11.4% dhe rënie e importit prej 34.4 për qind. Ndonëse rënia e eksportit nuk është lajm i mirë, ajo është shumë më e vogël edhe në vlerë relative, edhe në vlerë absolute se rënia e importit", ka thënë ai.

vijon në faqen e dytë

Institucionet i kthehen nismës për muze në ish-Burgun e Prishtinës



Institucionet shtetërore i janë kthyer iniciativës që ish-Burgu i Prishtinës të shndërrohet në muze. Me shumë se një vit pasi një komision parlamentar kishte dalë me këtë propozim, tash Qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë. Ka nxjerrë një vendim, nëpërmjet të cilit i obligon disa institucione që të merrren me këtë punë. Do të punohet që ndërtesa harkore e rrethuar me tela me gjemba...

Faqe 12



BASHKIMI EVROPIAN DEKLAROHET UNIK SA U PËRKET KORNIZAVE DHE PARIMEVE NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Brukseli kërkon marrëveshje për të gjitha çështjet e pazgjidhura

Me gjithë deklaratat kontradiktore sa u përket opsioneve dhe kompromiseve që mund të shkojnë deri në shkëmbim territore, zyrtarë të Bashkimit Evropian kanë folur për veprime intensive në rinisjen e dialogut Kosovë-Serbi. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Peter Stano, ka thënë për "Kohën Ditore" se prioriteti i tyre është lehtësimi i palëve drejt një marrëveshjeje finale që trajton të gjitha problemet e pazgjidhura mes dy vendeve, por të njëjtën kohë respekton vlerat evropiane dhe të drejtën ndërkombëtare

vijen nga ballina

Weber: BE-ja po e rikthen dialogun

Një marrëveshje e tillë duhet të jetë në përputhje me Acquis të BE-së (tërësia e ligjeve të BE-s, v.j.), në përputhje me vlerat e BE-së, si dhe në respektim të ligjeve ndërkombëtare", ka theksuar Stano. Për të qenë e qëndrueshme, siç ka thënë zyrtari nga Brukseli, marrëveshja duhet gjithashtu të jetë e pranueshme për rajonin dhe shtetet anëtare të BE-së.

"Ky është mesazhi të cilin ua ka përcjellë partnerëve edhe M.Lajçak, i cili është emëruar dhe vepron në emër të HRVP J.Borrell", ka përfunduar Stano.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Joseph Borrell, në një intervistë për KOHËN, kishte deklaruar se opioni i shkëmbimit është një çështje që duhet të zgjidhet në dialog mes Serbisë dhe Kosovës. Sipas asaj që pati thënë Borrell, nëse palët merren vesh duhet ta studiojnë atë marrëveshje.

Zyrtarisht, Bashkimi Evropian vazhdon të mbetet i mandatuari i vetëm nga OKB-ja për ta udhëhequr dialogun.

Në një opinion të botuar ekskluzivisht në KOHA, ministri i Jashtëm francez, Jean-Yves Le Drian, dhe ai gjerman, Heiko Maas, kanë thënë se janë të vendosur që t'i zgjidhin të gjitha pengesat e mbetura mes Serbisë e Kosovës.

Një qasje serioze kërkon negociatat të strukturuar mirë, të thella, me BE-në si ndërmjetës luajalë. Nevojitet një ndërmjetës më solid dhe vendosmëri politike – gjë që mund ta prisni nga Miroslav Lajçaku dhe ekipi i tij – me mbështetjen nga ana e përfaqësuesit të lartë Borrell, si dhe atë të Berlinit dhe Parisit", kanë shkruar ata.

Bushati: Sinjal inkurajues nga Gjermania dhe Franca për dialogun Kosovë-Serbi

Ish-ministri i Puneve të Jashtëm të Shqipërisë, Dëmir Bushati, e ka vlerësuar inkurajues letrën e përbashkët të ministrave të Jashtëm të Gjermanisë dhe Francës, të cilët kërkuar rifillimin e menjëhershëm të dialogut Kosovë-Serbi, nën udhëheqjen e Bashkimit Evropian.

Sipas Bushatit, për arrijtjen e një marrëveshjeje finale Prishtinë-Beograd është thelbësore që të ketë bashkëpunim transatlantik.

"Sinjale inkurajuese nga Heiko Maas dhe Jean Yves Le Drian në lidhje me rolin e BE-së në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Bashkëpunimi transatlantik është thelbësor për të arritur një zgjidhje përfundimtare, për t'i parandaluar liderët që t'i shfrytëzojnë ndarjet transatlantike dhe imponimin e një zgjidhjeje etnocentrike", ka shkruar Bushati në "Facebook".

Analisti politik në Këshillin Gjerman për Demokracizim, Bodo Weber, vlerëson se do të ishte keqlexim i deklaratës së ministrit francez dhe atij gjerman, nëse interpretohet si një thirrje për të rifilluar menjëherë negociatat.

"Artikulli është se pari një rekomandim i fortë nga Berlioni dhe Parisi për ta marrë rolin kryesor në dialog, dhe për të theksuar se dialogu në të kaluarën ka qenë, dhe mbetet ai i udhëhequr nga BE-ja. Së dyti, fjalja më e rëndësishme për mua është insistimi se 'nuk ka zgjidhje të shkurtra dhe rregullim të shpejtë', ka thënë Weber për "Kohën Ditore". Sipas tij, kjo qartësisht i referohet frikës së ngritur ditëve të fundit, se nëse mund të ketë një shtytje të përtëritë për një rregullim të shpejtë dhe të rremë, "do të thotë marrëveshje për shkëmbimin e territoreve, para zgjedhjeve presidenciale të SHBA-së, në gusht-shtator".

Zyra e Kryeministrit e ka mirëpritur këtë qëndrim të diplomateve evropiane. Por thonë se dialogu duhet të mos ketë si epilog një marrëveshje të shpejtë, por duhet të jetë i përgatitur mirë.

"Ne kemi treguar gatishmëri për të udhëhequr me dialogun, kurdo që ai fillon. Madje, që nga muaji mars i këtij viti ne kemi propozuar edhe modelin e përfaqësimit në këtë proces, duke paraparë dy epike të dialogut; njërin politik-përfaqësues, kurse tjetrin këshillues-profesional, qëllimi i të cilëve është që të kemi një përfaqësimit sa më gjithëpërfshirës dhe politik, por edhe profesional e akademik", ka thënë për KOHËN zëdhënësi i Qeverisë, Përpamir Kryeziu.

"Ne tashmë kemi bërë veprimin e



Në Zyrën e Komisionit Evropian kanë thënë se BE-ja është unike sa u përket kornizave dhe parimeve që duhet ndjekur në dialogun mes dy vendeve, dhe se nuk ka dallime në qëndrime

parë drejt rifillimit të dialogut me rastin e heqjes së tarifës 100% dhe vendosjen e reciprocitetit, veprim ky i cili vlerësohet në deklaratën e përbashkët. Qeveria e Republikës së Kosovë mirëpret dhe vlerëson faktin që këto dy shtete kërkojnë nga Serbia që të dëshmojë vullnetin e saj për rifillim të dialogut duke ndalë fushatën për çnjoje dhe duke hequr barrierat jotarifore".

Heqja e tarifës e kanë vlerësuar si hap pozitiv edhe ministrat e Jashtëm të Gjermanisë, përkatësisht Francës.

Analisti Weber vlerëson se mund të paraqiten pengesa në përjekjen për arrijtjen e marrëveshjes.

"Duke marrë parasysh skenarët e ndryshëm të mundshëm që lidhen me vendimin e ardhshëm të Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e situatës pas votimit të mocionit të mosbesimit, nga njëra anë, dhe zgjedhjet parlamentare të qershorit në Serbi nga ana tjetër, një rund i ri i negociatave të Brukselit nuk mund të ndodhë para korrikut, me gishtin më realist", ka thënë Weber.

Sipas tij, pengesat kryesore në njërin anë është performanca e të dërguarit amerikan Grenell, "që minon rolin kryesor të BE-së në negociatat dhe krijon hapësirë manovruese për elitat politike në Kosovë që ndjekin synimet e brendshme politike, dhe nga ana tjetër konfuzionin e prodhuar nga BE-ja vetë në lidhje me vendosmërinë e saj për t'i udhëhequr negociatat për një marrëveshje përfundimtare,

gjithëpërfshirëse bazuar në parimet dhe synimet që përbëjnë dialogun politik në vitet 2012-13". Weber thotë se, BE-ja po përpiqet t'i japë fund qasjes armiqësore të Serbisë që kundërshton shtetësinë e Kosovës.

Grenelli mbetet emisar

Shtetet e Bashkuara, që janë përfshirë aktivisht në dialog, e kanë lënë në dorën e Kosovës dhe të Serbisë që të arrijnë zgjidhjen që duan. Me ndërmjetësimin e emisarit të presidentit Trump, ambasadorit Richard Grenell, deri tani janë nënshkruar edhe disa marrëveshje si shprehje vullneti për hapjen e linjave hekurudhore dhe ajrore. Richard Grenell do të mbetet i dërguar i posaçëm i administratës Trump për dialogun Kosovë-Serbi, pas lajmit se ai do të tërhiqet nga pozita e ambasadorit të SHBA-së në Berlin, ka deklaruar zëdhënësi i tij, Dick Custin.

"Ai pret që dialogu të vazhdojë sa më parë, pora që të finalizohet krijimi i Qeverisë në Kosovë", ka thënë zëdhënësi i tij, Dick Custin, për REL. Ai është pyetur nëse vendimi për tërheqje nga pozita e ambasadorit do të ketë ndikim në rolin e tij si i dërguar për dialogun dhe se kur pritet hapi i parë drejt dialogut.

Mediet gjermane, të dielen, kanë raportuar se Grenelli do të tërhiqet nga pozita e ambasadorit amerikan në Gjermani brenda disa javësh.

Sipas informatave të agjencisë gjermane të lajmeve, DPA, 53-

vjeçari do të tërhiqet shumë kohë para zgjedhjeve presidenciale në SHBA, me 3 nëntor. Robin Quinville, që ka qenë zëvendës e Grenellit, pritet t'i marrë përsipër detyrat e tij.

Spektri politik në Kosovë vazhdon të jetë i përcarë sa i përket agjendës së dialogut. Prej më shumë se dy vjetësh, presidenti Hashim Thaçi ka marrë primatin në negociatat, duke zhvilluar edhe disa takime me homologun e tij serb, Aleksander Vučić. Por, e kanë mohuar se tashmë ekziston ndonjë draft-marrëveshje, ashtu siç pretendon kryeministri në detyrë Kurti. Një nga arsyt e rrezimit të Qeverisë ishte pikërisht hedhja e pengesave në dialog, ku LDK-ja do të kundërshtonte vendosjen e reciprocitetit me Serbinë, masë kjo e cila u kundërshtua edhe nga emisari i presidentit amerikan, Donald Trump, për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell.

Pas paralajmërimeve për rinisjen e dialogut Kosovë-Serbi, është aktivizuar edhe Rusia, duke rikujtuar se pa mbështetjen e tyre një marrëveshje eventuale nuk do të mund të miratohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Përfshirjen e Moskës e kanë mirëpritur edhe zyrtarë të Administratës Trump, të cilët merren me dialogun Kosovë-Serbi. Por, Qeveria ka kundërshtuar përfshirjen e Rusisë dhe rikthimin e çështjes së Kosovës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

© KOHA Ditore

Vetëvendosje publikon planin e votimit në kohë pandemie

PRISHTINË, 24 MAJ - Që prej mocionit të mosbesimit, Lëvizja Vetëvendosje ka insistuar në mbajtjen e zgjedhjeve të reja, menjëherë pas tejkalimit të situatës me pandeminë.

Në faqen e tyre në Facebook, VV-ja ka postuar një video përmes së cilës aktivistët e kësaj partie kanë demonstruar një proces votimi në kohë pandemie.

Sipas tyre, votimi në një kohë pandemie nuk ndryshon edhe aq prej atij pa të.

Përveç kujdesit të shtuar, Vetëvendosje thotë se gjithçka tjetër është e ngjashme.

"Aktivistët e Lëvizjes Vetëven-

dosje të frymëzuar nga forma e organizimit të zgjedhjeve në Korenë e Jugut, të mbajtura më 15 prillit 2020, kanë inskuaruar një proces të ngjashëm zgjedhor", thotë kjo parti.

Procesin e votimit e kanë ndarë në dy hapa - votuesit të kenë maska dhe të qëndrojnë 1.5 metra larg njëri-tjetrit gjatë kohës së pritjes në radhë, dhe votuesve t'u matet temperatura në hyrje të klasës.

"Nëse temperaturën e ka deri në 37.5 gradë celsius, votuesi mund të votojë në atë klasë me procedura sikur nga e kaluara vetëm me disa masa shtesë të sigurisë. Nëse temperaturën e ka më shumë se 37.5

gradë celsius, atëherë votuesi do të ndahet në një klasë tjetër ku i gjithë stafi i KQZ-së do të jetë i pajisur me veshje kundër pandemisë COVID-19. Pas votimit ai/ajo shoqërohet për t'i bërë analizat", thotë VV-ja.

Sipas tyre, zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje.

"Këtu e 28 vjet më parë po mbaheshin zgjedhjet e para në Kosovën e okupuar. Ndonëse nën shtetëritim nga Serbia e pa institucione, populli i Kosovës arriti t'i organizojë zgjedhjet e para në vend. Tani mundësitë janë edhe më të mëdha dhe se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje".

(koha.net)

